12/2018

# Pontes

## Inter Nos

## **Prospectus**

ALUMNI REUNION SUPLEMENT

**L'INCUBATORE DELLE IDEE**

***FATTI STORICI***

***FAKTE HISTORIKE***

Christmas Edition

**2294** **studenti iscritti**
studentë të regjistruar

**studenti stranieri** **600**
studentë të huaj

**40** **eventi in un Anno Accademico**
veprimtari në një vit akademik

**1700** **laureati**
të diplomuar

**85 %** **impiegati**
të punësuar

**45 %**
**impiegati fuori paese**
të punësuar jashtë vendit

**55 %**
**impiegati in Albania**
të punësuar në Shqipëri


*Pubblicato dalla*
**Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio**

*A cura di:*
Padre Daniele **Bertoldi**
Presidente della Fondazione
Nostra Signora del Buon Consiglio

Prof. Bruno **Giardina**
Magnifico Rettore dell'Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"

*Da un'idea di // Një ide nga:*
dott.ssa Daniela **Kostandini**
dott.ssa Diana **Hila**
arch. Elva **Margariti**
dott.ssa Enilsa **Magjistari**

*Grafica di // Përpunimi grafik*
Fredi **Dragusha (grafplus)**

*Botim i*
**Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë**

*Nën kujdesin e:*
Atë Daniele **Bertoldi**
President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë

Prof. Bruno **Giardina**
Rektor i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"



Contattateci// Na kontaktoni
*pontes@unizkm.al*

# Sommario
## Përmbajtja


**4-7**
**Editoriale//**
**Editorial**

**10**
UCNSBC//
UKZKM TOUR

**8-9**
**Atenei partner//**
**Universitetet partnere**

Alumni
Reunion
**SUPLEMENT**

**11**
**INTER NOS**
*Ensuela Prenga*

**14**
**Prospectus**
Il mercato
del lavoro//
Tregu i punës

**18-19**
L'Accademia dei "100 villaggi"//
Akademia "100 Fshatrat"

**23-25**
Fatti storici//
Fakte historike




# Editoriale// Editorial



*Erion VELIAJ*
*Kryetari i Bashkisë, Tiranë*
*Sindaco di Tirana*

Carissimi studenti,
illustri professori!

Prima di augurarvi un buon anno accademico, permettetemi di dichiarare che Tirana è ormai la vostra città e voi siete i suoi cittadini. Avete scelto la città giusta, perché Tirana non è solo il capoluogo dell'istruzione di questo Paese, ma anche il suo quartier generale economico-culturale.

Mi piace sottolineare che il Comune di Tirana considera la gioventù una priorità assoluta, per la quale ci sarà sempre una porta aperta. Per questo motivo, abbiamo avviato la trasformazione di Tirana iniziando dai più piccoli, dagli alunni e dagli studenti, costruendo asili nido e nuove scuole, nuove strutture sportive, parchi giochi e biblioteche.

La nostra città diventa migliore con l'arrivo di nuovi studenti, nonché devoti cittadini. Le risorse umane rappresentano il nostro valore più grande ed è per questo motivo che, tutta la nostra attenzione è indirizzata a voi! Da qui la decisione di trasformare la Piramide in un Centro di Educazione per la Tecnologia. Il concetto è quello di "imparare facendo" (Learning by doing), e in quanto tale, la Piramide si trasformerà in un moderno centro culturale di educazione per i media, le arti visive, le scienze umanistiche, la musica, il cinema e la tecnologia.

Scegliendo l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" avete preso la giusta decisione poiché questo Ateneo rappresenta un esempio unico di un'istituzione universitaria che forma gli studenti come si dovrebbe, sia sul piano accademico che professionale, ed inoltre contribuisce alla costruzione di ponti di comunicazione tra diverse nazioni, come l'Italia e l'Albania. Confido nell'idea che investire nell'istruzione sia la chiave dello sviluppo individuale e della società. Il cambiamento ed il progresso di Tirana è oggi una realtà! Tutti amano il cambiamento, ma pochi

sono disposti a farlo. I giovani come voi hanno sempre abbracciato e sostenuto il cambiamento! Ed è per questo che vi ringrazio! Voi rendete il mio lavoro più facile.

Una volta terminato il percorso universitario, potrete scegliere una carriera nel settore privato o pubblico. Il comune di Tirana ha un ruolo importante in entrambe le opzioni. Da una parte, stiamo progettando nuovi scenari per una città attrattiva per investitori stranieri e locali, che interessano diversi settori dell'economia. Vi sosterremo inoltre a creare le vostre aziende, trasformandovi da dipendenti in datori di lavoro. Tutto questo è reso possibile dal supporto immancabile che abbiamo fornito e continueremo a fornire alle Start-Up con progetti quali IDEA, MAKE IT IN ALBANIA ed altri programmi.

Dall'altro canto, abbiamo creato la possibilità di tirocini formativi, dove vengono coinvolti solo i migliori studenti. A noi non interessa il punto di vista politico o la provenienza. Riteniamo importante l'essere produttivi e l'uso al meglio del proprio tempo per la crescita professionale, attraverso tirocini ed esperienze di volontariato. Abbiamo appena approvato una delibera sull'implementazione del progetto "I giovani verso una professione ", tramite il quale il Comune di Tirana offrirà ai neolaureati la possibilità di stage e tirocini retribuiti, con una durata da tre a sei mesi.

Scegliendo l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" avete preso la giusta decisione poiché questo Ateneo rappresenta un esempio unico di un'istituzione universitaria che forma gli studenti come si dovrebbe, sia sul piano accademico che professionale, ed inoltre contribuisce alla costruzione di ponti di comunicazione tra diverse nazioni, come l'Italia e l'Albania.

Infine, un messaggio sulla vita culturale della capitale, ricca di concerti di noti musicisti pop, opera e teatri. Vi invito a partecipare ai concerti in Piazza Skanderbeg, al Nuovo Bazar (Pazari i Ri), all'anfiteatro del Lago Artificiale di Tirana o all'ex "Blloku" per un Street Party. Non perdetevi nemmeno le mostre al Museo Storico Nazionale, alla Galleria delle Arti o gli spettacoli del Teatro Metropol. Fatte tanta attività fisica e partecipate alla Maratona di Tirana o ai Survivor Games.

La domanda che vi dovete porre è: Cosa volete fare della vostra vita? Potete girare le strade di Tirana, o magari chiedervi: Ehilà, qui c'è una maratona! Bisogna che corra, perché mentre io riposo, qualcun altro sta correndo.

In bocca al lupo!

Të nderuar studentë,
të nderuar profesorë!

Përpara se t'ju uroj për një vit akademik sa më të sukseshëm, më lejoni të them se Tirana është tashmë qyteti juaj, kurse ju jeni qytetarët e saj. Keni zgjedhur qytetin e duhur sepse është jo vetëm kryeqendra arsimore e këtij vendi, por edhe kryeqendra ekonomike e kulturore e Shqipërisë. Bashkia e Tiranës është një portë e hapur për ju, ndaj dua ta nënvizoj që në fillim se për ne, rinia, është prioritet kryesor. Kjo është arsyeja pse transformimin e Tiranës e filluam nga fëmijët, nxënësit dhe studentët, me çerdhe dhe shkolla të reja, me mjedise të reja sportive, kënde lojrash për më të vegjlit dhe bibliotekat e lagjeve.

Shtimi i Tiranës me studentë dhe me qytetarë të rinj e të devotshëm, e bën qytetin tonë më të mirë. Burimet njërëzore janë pasuria më e çmueshme që kemi, prandaj e gjithë vëmendja jonë është tek ju! Kjo është arsyeja pse kemi vendosur që Piramida të shndërrohet në një Qendër të Edukimit për Teknologjinë. Koncepti do të jetë mësimi nëpërmjet praktikës (Learning by doing) dhe si e tillë, Piramida do të funksionojë si një qendër kulturore moderne për media, arte pamore, shkenca humane, muzikë, film dhe edukimit për teknologjinë.

Duke zgjedhur Universitetin Katolik ZKM keni marrë vendimin e duhur sepse është vërtet shembull unik se si një institucion arsimor duhet të edukojë aftësi akademike dhe profesionale, por edhe të ndërtojë ura komunikimi midis kombeve të ndryshme, si kjo mes Italisë dhe Shqipërisë. Jam i besimit se investimi në arsim është çelësi i zhvillimit të individit dhe shoqërisë. Zhvillimi dhe ndryshimi i Tiranës sot është realitet. Të gjithë e duan ndryshimin, por jo të gjithë duan të ndryshojnë kur vjen puna për veten, e mandej disa hezitojnë.

Duke zgjedhur Universitetin Katolik ZKM keni marrë vendimin e duhur sepse është vërtet shembull unik se si një institucion arsimor duhet të edukojë aftësi akademike dhe profesionale, por edhe të ndërtojë ura komunikimi midis kombeve të ndryshme, si kjo mes Italisë dhe Shqipërisë.

Por, jo të rinjtë si ju, ju jeni gjithmonë të hapur ndaj ndryshimit dhe e përkrahni atë. Faleminderit! Ma bëni punën time më të thjeshtë.
Pasi të aftësoheni këtu në universitet, duhet të zgjidhni nëse dëshironi një karrierë në sektorin privat ose atë publik. Bashkia ka rol në të dyja zgjedhjet. Nga njëra anë, po përmirësojmë aftësinë tërheqëse të Tiranës për investitorët e huaj




La conferenza "Essere città, oggi"// Konferenca "Të jesh qytet sot"

dhe të vendit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Gjithashtu, nëpërmjet mbështetjeve të Start-Up me programe si IDEA, MAKE IT IN ALBANIA dhe disa programe të tjera, do t'ju ndihmojmë që të krijoni kompaninë tuaj duke u kthyer nga punëkërkues në punëdhënës.

Nga ana tjetër, kemi krijuar programe të rëndësishme internshipi në Bashki, ku përzgjidhen vetëm studentët më të mirë. Për ne, nuk ka rëndësi pikëpamja politike ose prejardhja. Rëndësi ka në qoftë se aktivizoheni dhe keni dëshirë ta përdorni kohën tuaj për rritjen e aftësive tuaja profesionale, përmes internship-eve dhe vullnetarizmit. Sapo kemi miratuar një Projekt-Vendim për zbatimin e projektit "Të Rinj dhe të Reja Drejt një Profesioni" ku Bashkia Tiranë do të paguajë praktikat/intershipet e të sapo diplomuarve për 3 deri në 6 muaj.
Dua ta mbyll me një mesazh për jetën kulturore të Tiranës. Nga koncertet e divave pop, tek opera, teatrot, mesatarisht në qytetin tonë ka çdo ditë 3-4 performanca. Ju ftoj të bëheni pjesë e koncerteve në Sheshin Skënderbej, tek Pazari i Ri, tek Amfiteatri i Liqenit të Tiranës, ose tek një Street Party tek ish-Blloku. Mos neglizhoni edhe të shikoni një ekspozitë tek Muzeu Historik Kombëtar, tek Galeria e Arteve, por edhe një shfaqje tek Teatri Metropol. Mos harroni edhe ushtrimin fizik dhe të merrni pjesë në Maratonën e Tiranës ose në Survivor Games.

Pyetja është se çfarë do të bëni me jetën tuaj? Mund të vini vërdallë nëpër Tiranë ose mund të thoni: Hej, kjo është një maratonë, duhet vrapuar përditë sepse ndërkohë që unë jam pushim, po vrapon dikush tjetër.

Suksese!

# Atenei partner// Universitetet partnere

Fondata nel 2004, l'UCNSBC è nata come parte della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio ed è una delle prime iniziative dell'istruzione universitaria privata in Albania.

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" è l'unica università privata in Albania, che grazie alle convenzioni con le università pubbliche italiane, rilascia titoli di studio riconosciuti in tutta l'Unione Europea. Ultimamente, l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ha ottenuto il terzo accreditamento istituzionale e una valutazione massima in punteggio, avendo soddisfatto tutti i requisiti e gli standard richiesti a livello accademico e strutturale.

**Facoltà di Scienze Applicate - Laurea Specialistica in Architettura.** Il corso di laurea in Architettura ha una durata normale di 5 anni e si realizza in collaborazione con l'Università di Firenze. Gli studenti laureati ottengono una Laurea Doppia (Double Degree) e potranno esercitare la loro professione di Architetto in Albania, Italia e in qualsiasi altro paese dell'Unione Europea.

**Facoltà di Scienze Economiche, Politiche e Sociali** - programma di studio in Economia Aziendale Bachelor (laurea triennale) che ha una durata di tre anni accademici e viene realizzato in collaborazione con l'Università degli Studi di Bari Aldo Moro.

Themeluar në vitin 2004, UKZKM lindi si pjesë e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë dhe përbën një nga nismat e para të arsimit universitar jopublik në Shqipëri.

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është i vetmi universitet jopublik në Shqipëri, diplomat e të cilit, falë partneritetit me universitetet publike italiane, njihen edhe në Bashkimin Europian. Së fundmi, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" fitoi akreditimin e tretë institucional, me maksimumin e pikëve, duke përmbushur plotësisht kriteret dhe standartet e kërkuara në nivel akademik dhe infrastukturor.

**Fakulteti i Shkencave të Aplikuara - Master i Shkencave në Arkitekturë** Programi i studimit në Arkitekturë zhvillohet si një cikël unik 5-vjeçar dhe vjen në bashkëpunim me Universitetin e Firences në Itali. Në përfundim të studimeve studentët pajisen me një Diplomë të Dyfishtë (Double Degree), që u mundëson ushtrimin e profesionit të arkitektit në Shqipëri, Itali dhe çdo vend tjetër të Bashkimit Europian.

**Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale** - Dy programet e studimit Bachelor kanë një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike dhe realizohen në partneritet me Universitetin e Studimeve të Barit, Aldo Moro.

Questa collaborazione rilascia una Laurea Congiunta (Joint Degree). Il Corso di Laurea in Economia Aziendale si pone come obiettivo di offrire le nozioni circa la realtà dell'azienda nelle sue diverse aree: finanza, amministrazione, contabilità, marketing e in altri settori che coinvolgono il profilo professionale. Il Master Professionale, la Laurea Specialistica in Economia e Management sono programmi di studio del secondo ciclo susseguiti dal Dottorato di Ricerca in Statistica che fa parte del terzo ciclo.

Ky bashkëpunim bën të mundur lëshimin e një Diplomë të Përbashkët (Joint Degree). Studentët që zgjedhin Programin e Studimit Ekonomi Ndërmarrjeje marrin njohuri të plota në: financë, administrim biznesi, menaxhim, kontabilitet, marketing dhe të tjera fusha të këtij profili profesional. Master profesional, Master shkencor në Ekonomi dhe Menaxhim, si dhe Doktoratë në Statistikë janë programet e ciklit të dytë dhe të tretë, që mund të përzgjidhen pas diplomimit.

**Facoltà di Farmacia** – Il corso di laurea in Farmacia, ha una durata di 5 anni accademici. Offre agli studenti una preparazione teorico-pratica, fornendo delle competenze e conoscenze atte ad operare nei settori della ricerca, della produzione dei preparati, per far parte dell'industria farmaceutica. Al termine del ciclo di studi, lo studente ottiene una laurea congiunta tra l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" e l'Università degli Studi di Bari Aldo Moro e con la relativa abilitazione professionale può svolgere la professione di farmacista non solo in Albania ma anche in Europa.

**Fakulteti i Farmacisë** - Programi i studimit në Farmaci, zgjat 5 vite akademike dhe ka për qëllim të formojë një figurë të kompletuar, të aftë të përgatisë preparate, të kryejë kërkime shkencore, por edhe i gatshëm për të qenë pjesë e industrisë farmaceutike. Farmacisti i diplomuar merr një diplomë të Përbashkët nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universiteti i Studimeve të Barit, Aldo Moro.
Pas aftësimit profesional, farmacisti mund të ushtrojë aktivitetin jo vetëm në Shqipëri, por kudo në Europë.

**Facoltà di Medicina e Chirurgia** – Il Programma di Studio in Medicina e Chirurgia e Odontoiatria e Protesi Dentaria sono a ciclo unico con una durata di 6 anni accademici. I Programmi di Studio in Fisioterapia e Infermieristica, (Bachelor) hanno una durata di 3 anni accademici. I quattro corsi di laurea vengono realizzati in collaborazione con l'Università di Roma "Tor Vergata". Al termine del percorso formativo viene rilasciata una Laurea Congiunta riconosciuta in tutti i paesi dell'Unione Europea.

**Fakulteti i Mjekësisë** - Programet e studimit në Mjekësi dhe Odontoiatri e Protezë Dentare realizohen në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata" dhe zhvillohen si cikël unik 6-vjeçar. Edhe Programet e Studimit në Fizioterapi dhe Infermieristikë, me kohëzgjatje 3-vjeçare vijnë në partneritet me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Në përfundim të studimeve lëshohet një Diplome të Përbashkët, e vlefshme në vendet e Bashkimit Europian.

# UCNSBC// UKZKM TOUR







Il percorso universitario definisce il tuo futuro, per questo bisogna viverlo al meglio presso l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio"!
Il modo migliore per conoscere UCNSBC, sono gli incontri con lo staff dell'Università nelle Scuole Superiori Secondarie dell'Albania e del Kosovo. Attraverso l'UCNSBC Tour per l'orientamento alla carriera, gli alunni vengono informati sui i Corsi di Laurea. La nostra filosofia è che lo studente è la priorità #1.

Se desiderate che il nostro staff visiti la vostra scuola,
scriveteci al: pontes@unizkm.al

Rrugëtimi universitar përcakton të ardhmen tuaj, ndaj përjetojeni bukur në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"!
Mënyra më e mirë për të mësuar mbi UKZKM-në, janë takimet me stafin e universitetit, në shkollat e mesme të Shqipërisë, Kosovës e më gjerë.
Në kuadër të këshillimit dhe orientimit të karrierës, të gjithë maturantët do të njihen me programet e studimit nëpërmjet UKZKM Tour! Në filozofinë tonë, studenti është prioriteti #1.

Nëse dëshironi që stafi ynë të vizitojë shkollën tuaj,
na shkruani në: pontes@unizkm.al



# INTER NOS

## La Fisioterapista dei bambini// Fizioterapistja e fëmijëve

*Ensuela Prenga*
*Specialista in Fisioterapia Pediatrica*
*Specialiste në Fizioterapi Pediatrice*

Generazione dopo generazione gli studenti laureati all'Università Cattolica NSBC sono i più richiesti sul mercato del lavoro e sono stati assunti nel settore sanitario, privato e pubblico, sono liberi professionisti o dirigono il business familiare. Alcuni fanno parte dello staff delle strutture sanitarie della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio, perché l'UCNSBC si prende cura dei propri studenti, non soltanto durante la formazione accademica ma li sostiene anche nella loro carriera. Un esempio è Ensuela Prenga, laureata in Fisioterapia nel 2009. Dopo la sua laurea specialistica in Fisioterapia Pediatrica all'Università di Firenze, Ensuela è stata assunta come fisioterapista presso il reparto di pediatria del Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport. Da giugno del 2013, Ensuela tratta circa sei bambini al giorno, bambini con disturbi neurologici e sindromi genetiche. "Nella nostra clinica il programma di trattamento per ogni bambino è individuale e viene consulto due volte all'anno dal il noto neuropediatra italiano Prof. Renato Borgatti. Il trattamento prevede oltre il trattamento diretto sul bambino anche la collaborazione dei genitori", ci racconta Ensuela.



Brez pas brezi, studentët e diplomuar në Universitetin Katolik ZKM janë ndër më të kërkuarit në tregun e punës dhe janë pozicionuar mirë si në sektorin shtetëror, ashtu edhe në atë privat, janë profesionistë të lirë ose drejtojnë biznese familjare. Një pjesë e tyre është punësuar pranë strukturave shëndetësore të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë, pasi UKZKM kujdeset për studentët, jo vetëm gjatë formimit akademik, por i mbështet edhe më tej në karrierën e tyre. Shembull i kësaj është Ensuela Prenga. U diplomua në UKZKM në Programin e Studimit Fizioterapi në vitin 2009. Pas specializimit për Fizioterapi Pediatrike në Universitetin e Firences, Ensuela u punësua si fizioterapiste pranë repartit të pediatrisë në Qendrën e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive. Prej qershorit të vitit 2013, ajo trajton mbi 6 fëmijë në ditë, të cilët paraqesin problematika neurologjike dhe sindroma gjenetike. "Në klinikën tonë, programi i trajtimit për çdo fëmijë është individual dhe konsultohet dy herë në vit me neuropediatrin e njohur italian për fëmijë Prof. Renato Borgatti. Trajtimi parashikon që përveç ndërhyrjes direkte tek fëmija, të punohet edhe me prindërit", tregon Ensuela.

# Dedicato alla salute//
# Përkushtuar Shëndetit

## Il Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport compie 10 anni!

Una decade coi servizi qualitativi e standard europei nel campo della riabilitazione. La Clinica di Riabilitazione offre diversi servizi, come: Riabilitazione Pediatrica, Terapia Fisica Strumentale, Visita medica, Terapia manuale, Tesar Therapy, Ipertermia – Smart Therapy Laser Yag. La CRMS, ha portato in Albania per la prima volta altri servizi come: Idrochinesiterapia, Formetric 3D e Shockwave Therapy, Onde d'Urto Focali. Negli ambienti della clinica si trovano due palestre e una piscina che sono in funzione dei pazienti.

Obiettivo del Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport è anche la preparazione dei professionisti e la consapevolezza sulla Fisioterapia. In collaborazione con le Istituzioni accademiche italiane CRMS ha contribuito alla formazione e alla laurea degli studenti del Programma di Studio in Fisioterapia e a sostenere i professionisti.

Il Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport è stato inaugurato il 3 dicembre 2008, iniziativa dell'ONG Dokita e della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio e grazie al finanziamento della Cooperazione Italiana.




*Staff del Centro di Riabilitazione e Medicina dello Sport //*
*Stafi i Qendrës së Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive*







## Qendra e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive mbush 10 vjet!

Qendra e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive mbush 10 vjet! Një dekadë me shërbime cilësore dhe standarte europiane në fushën e rehabilitimit.
Klinika e Rehabilitimit ofron shërbime të ndryshme, si Rehabilitimi Pediatrik, Terapia Fizike Strumentale, Vizitë mjekësore, Terapia manuale, Tecar Therapy, Hipertermia - Smart Therapy, Laser Yag. Por QRMS, ka sjellë në Shqipëri edhe shërbime risi, siç janë: Hidrokineziterapia, Formetric 3D dhe Shockwave Therapy Onde d'Urto Focali. Në ambientet e saj bashkëkohore, gjenden dy palestra dhe një pishinë, në funksion të pacientëve.
Objektiv i Qendrës së Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive është edhe përgatitja e profesionistëve dhe ndërgjegjësimi mbi Fizioterapinë. Në bashkëpunimin me institucione akademike italiane, QRMS ka kontribuar në formimin dhe diplomimin e studentëve të Programit të Studimit në Fizioterapi dhe mbështetjen e profesionistëve.
Qendra e Rehabilitimit dhe Mjekësisë Sportive u inagurua më 3 dhjetor të vitit 2008, si nismë e OJF Dokita-s dhe Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë me bashkëfinancimin e Kooperacionit Italian.

# Il mercato del lavoro//
# Tregu i punës

## *Un ? in meno all' UCNSBC!*

Il mercato del lavoro dei paesi dell'Unione Europea, ma anche dei paesi extra UE, è caratterizzato da un'elevata competitività. L'Europa richiede al neolaureato un alto livello di preparazione, ma allo stesso tempo un diverso approccio psicologico al mercato del lavoro. Il modello accademico dell'Università Cattolica NSBC, che in collaborazione con le università italiane offre corsi di laurea aggiornati in linea con le tendenze del mercato del lavoro, prepara studenti in grado di interfacciarsi sia con il panorama albanese, si con il panorama comunitario.
Sulla base dei fattori di sviluppo, l'Unione Europea e gli Stati Uniti offrono diverse tipologie di lavoro, nelle quali le professioni più richieste e più retribuite per l' anno 2018, secondo alcuni studi internazionali sono le seguenti: **Medico – Infermiere – Architetto e Ingegnere – Esperto di Finanza e Marketing – Esperto Informatico.**
Nel frattempo, i paesi che offrono i salari più alti per i cittadini stranieri, secondo uno studio di HSBC (uno dei più grandi gruppi bancari a livello mondiale) sono i seguenti: **Germania – Svezia – Emirati Arabi – Norvegia – Singapore – Austria.**

*Fonti: Glassdoor, Flexjobs, Businessinsider*

## *Një ? më pak në UKZKM!*

Tregu i punës, sidomos në nivel europian, ka konkurencë të lartë midis shteteve anëtare, por edhe atyre jashtë komunitetit. Europa kërkon përgatitje të madhe nga të sapodiplomuarit, por njëkohësisht edhe një përqasje psikologjike të ndryshme ndaj tregut të punës. Modeli akademik i Universitetit Katolik ZKM, i cili në bashkëpunim me universitetet partnere italiane ofron programe studimi të përditësuara, në të njëjtën linjë me nevojat e tregut të punës, i aftëson studentët të përballen me panoramën shqiptare dhe me atë komunitare. Bazuar tek faktorët e zhvillimit, Europa, por edhe Shtetet e Bashkuara ofrojnë variante të ndryshme punësh, ku profesionet më të kërkuara dhe më të paguara për 2018-ën, listohen si më poshtë: **Mjek - Infermier - Farmacist - Arkitektekt dhe Inxhinier - Ekspert Financiar dhe Marketingu - Ekspert në Teknologji Informacioni (ICT).**
Ndërkohë, sipas një studimi të HSBC-së (një prej grupeve bankare më të mëdha në botë) vendet të cilat ofrojnë pagat më të larta për shtetasit e huaj janë: **Gjermania - Zvicra - Emiratet e Bashkuara Arabe - Norvegjia - Singapori - Austria.**

*Burimet: Glassdoor, Flexjobs, Businessinsider*

# Suplement
Pontes

ALUMNI REUNION 2018



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

# Alumni Reunion 2018

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ha organizzato l'incontro Alumni Reunion, il 16 Ottobre 2018, presso il campus universitario.

Studenti e docenti dell'UCNSBC si sono riuniti per ritrovare le emozioni del percorso accademico, condividere storie di successo e per conoscere i progetti futuri dell'Università.

La cerimonia si è aperta con un brindisi e delle foto di gruppo per ogni facoltà.



Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi takimin Alumni Reunion, më datë 16 Tetor 2018, në ambientet e kampusit universitar.
Historitë e suksesit, emocionet e jetës universitare, si edhe prezantimi i arritjeve e projekteve të ardhshme të UKZKM-së mblodhën së bashku ish-studentë dhe profesorë të fakulteteve tona.
Takimi i parë i ish-studentëve nisi me një ceremoni mirëseardhjeje, ku nuk munguan fotot në grup për çdo fakultet.




Fjalën hapëse e mbajti Rektori i Universitetit, Prof. Bruno Giardina, për të vijuar më pas me Dekanin e Fakultetit të Mjekësisë, Prof. Giovani Arcudi dhe Prof. Giovanni Lagioia, Dekan i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale.

Il Magnifico Rettore, Prof. Bruno Giardina ha tenuto presso l'Aula Magna il discorso di benvenuto. Hanno succesivamente salutato i presenti il Prof. Giovani Arcudi, Preside della Facoltà di Medicina e Chirurgia e il Prof. Giovanni Lagioia, Preside della Facoltà di Scienze Economiche, Politiche e Sociali.











Aula Magna
16/10/2018

# Progetti futuri//
# Projektet e ardhshme



Gli alumni hanno seguito con molto interesse il discorso di Padre Daniele Bertoldi, Presidente della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio. Il Presidente ha parlato del futuro progetto della Fondazione - l'istituzione di un nuovo ospedale all'interno del campus universitario, sottolineando che gli alumni saranno i primi ad essere coinvolti in questo progetto.

Ish-studentët ndoqën me mjaft interes fjalën e Atë Daniele Bertoldi-t, President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë. Ai foli mbi ngritjen dhe funksionin e spitalit të ri brenda kampusit universitar, duke theksuar se ish-studentët janë prioritet për t'u bërë pjesë e këtij realiteti.






Il Coordinatore della Facoltà di Medicina e Chirurgia, Prof. Arvin Dibra ha presentato le nuove offerte accademiche e le Specializzazioni a Lungo Termine in Medicina presso l'UCNSBC.

Koordinatori i Fakultetit të Mjekësisë, Prof. Arvin Dibra paraqiti ofertat e reja akademike dhe Specializimet Afatgjata në Mjekësi, pranë UKZKM-së.



La dott.ssa Irsida Mehmeti del Dipartimento di Scienze Farmaceutiche ha presentato i Master Esecutivi ed i progetti in corso dell`UCNSBC.

Prezantimi i Masterave Ekzekutivë dhe projekteve aktuale në universitet vijoi me Departamentin e Shkencave Farmaceutike, përmes pedagoges Irsida Mehmeti.



Mentre la Prof.ssa Doris Madhi, la quale quest'anno ha conseguito il titolo di Dottorato di Ricerca in Statistica presso UCNSBC ha presentato questo corso di studio del terzo ciclo.

Ndërsa, pedagogia Doris Madhi prezantoi programin e studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në Statistikë, që e mbrojti këtë vit pranë Universitetit Katolik ZKM.

# Storie di  Successo//
# Histori Suksesi

Uno dei momenti più interessanti è stato il racconto delle personali storie di successo di alcuni degli Alumni.

Historitë e suksesit të studentëve të formuar në Universitetin Katolik ZKM shënuan një prej momenteve më interesante të mbrëmjes.



Rona Nushi

Ex studentessa di Farmacia, oggi è imprenditrice di successo nella produzione di prodotti cosmetici BIO.

Ish-studente e Farmacisë, sot është një sipërmarrëse e sukseshme në fushën e prodhimit të produkteve kozmetike.



Arisa Bidaj

Ex studentessa di Odontoiatria e Protesi Dentaria, oggi è responsabile della sua clinica odontoiatrica.

Ish-studente në Odontoiatri dhe Protezë Dentare, administron me krenari klinikën e saj private të stomatologjisë.



Ilvi Begolli

Ex studente di Fisioterapia è divenuto un esempio di successo. Attualmente dirige un centro di riabilitazione, dove ha assunto diversi studenti dell'UCNSBC.

Nga ish-student i Fizioterapisë, sot një shembull suksesi në këtë fushë dhe drejtues i një qendre private rehabilitimi, në të cilën ka punësuar studentë të UKZKM-së.



Sebastiana Bytyçi

Ex studentessa di Economia e Gestione Aziendale, oggi gestisce la sua  azienda di confezioni per il mercato tedesco del lavoro.

Ish-studente e Ekonomi dhe Administrim Ndërmarrjeje, sot menaxhon kompaninë e saj private të konfeksioneve orientuar për tregun gjerman të punës.

Quali sono le aspettative della nuova generazione? Alla domanda sul futuro professionale dei giovani ha risposto Erlis Uruçi, studente del quinto anno della Facoltà di Medicina e Chirurgia.
L'incontro si è concluso con un cocktail e la consegna di un regalo simbolico per gli Alumni.





Erlis Uruçi, student në vitin e pestë në Fakultetit të Mjekësisë prezantoi pritshmëritë që ka brezi i sotëm mbi të ardhmen profesionale në fushën e mjekësisë.
Takimi u përmbyll me një *cocktail* dhe dhuratën simbolike për ish studentët UKZKM.





# ALUMNI
# REUNION



# Fisioterapia ed Infermieristica// Fizioterapia dhe Infermieria

*Prof. Gennaro Rocco*
*Coordinatore del Corso di Laurea in Infermieristica e Fisioterapia*
*Koordinator i Programit të Studimit në Infermieristikë dhe Fizioterapi*

Tutti i paesi occidentali sono caratterizzati dal invecchiamento progressivo della popolazione. La disponibilità di terapie e tecnologie sempre più efficaci permette oggi la remissione di patologie prima fatali e la cronicizzazione di molte di esse: tutto ciò comporta un aumento della domanda di assistenza sanitaria. Nel suo recente rapporto del 2018 l'Organizzazione Mondiale della Sanità (OMS) lancia l'allarme della grave carenza di professionisti sanitari che solo nei Paesi Europei sarà di oltre un milione nel 2020. Le professioni che si occupano di assistenza e di riabilitazione sono quelle che presentano la maggiore criticità. In Italia la carenza di infermieri è di oltre 54 milla unità e la situazione va progressivamente peggiorando.
Scegliere di diventare infermiere o fisioterapista oggi, significa scegliere delle professioni intellettuali che sono al servizio dell'uomo e che permettono di trovare un lavoro rapidamente sia come dipendente sia come liberi professionisti. Offrono inoltre la possibilità di fare delle straordinarie carriere nella dirigenza con le Lauree magistrali, nelle specializzazioni cliniche con i Master e nelle Università con i dottorati di ricerca.

Vendet perëndimore karakterizohen nga mplakja progresive e popullatës. Terapitë dhe teknologjitë gjithnjë e më efikase, sot kanë mposhtur patologji, të cilat në fillesat e tyre ishin fatale dhe të natyrës kronike; e gjithë kjo ka rritur kërkesën për asistencë shëndetësore. Në raportin e saj më të fundit të vitit 2018, Organizata Botërore e Shëndetësisë lëshon alarmin e mungesës së theksuar të profesionistëve në sektorin shëndetësor. Në vitin 2020, Europa do të ketë nevojë për mbi një milion të tillë. Aktualisht, profesionet që lidhen me shërbimin shëndetësor dhe rehabilitimin janë në një pikë kritike. Në Itali mungesa e infermierëve llogaritet në mbi 54 mijë njësi dhe kjo situatë po përkeqësohet dita - ditës. Të zgjedhësh Infermierinë ose Fizioterapinë do të thotë të zgjedhësh një profesion në shërbim të njeriut. Me zotërimin e këtyre profesioneve, sot mund të sigurohet lehtësisht një vend pune në një strukture shëndetësore ose si profesionist i lirë. Përveç kësaj, Infermieristika dhe Fizioterapia  të japin mundësinë për të ngjitur shkallët e karrierës në nivele drejtuese, të vazhdosh specializimet pas masterit, si edhe të bëhesh pjesë në botën akademike përmes doktoratave.



## Dottorato di Ricerca in Statistica// Doktoratë në Statistikë

Il mese di settembre 2018 ha portato i primi Dottori di ricerca in Statistica. I candidati hanno presentato in Aula Magna i loro elaborati, realizzati sulla base di una ricerca scientifica durata tre anni.
Principale obiettivo dell'indirizzo di Ricerca in Statistica è l'acquisizione di un'approfondita preparazione nel campo della metodologia statistica per le applicazioni a particolari contesti e problemi di ricerca. In particolare, i settori d'interesse si rivolgono ad ambiti aziendali, sociali, economici, informatici, biologici, ambientali, ecc. La finalità dell'Dottorato di Ricerca in "Statistica" è quella di uniformare il livello di preparazione dei dottorandi in: calcolo delle probabilità, inferenza statistica e modelli lineari, metodi statistici per la finanza, le assicurazioni, metodi statistici per la pubblica amministrazione, tecniche di campionamento e sondaggi demoscopici, marketing strategico e operativo, metodi statistici per il marketing.

Muaji shtator 2018 shënoi krijimin e brezit të I-rë, që fitoi titullin Doktor Shkencash në Statistikë, pranë UKZKM-së. Kandidatët mbrojtën dizertacionin, duke prezantuar punimet e tyre shkencore të realizuara përgjatë tre viteve.
Objektivi kryesor i Programit të Doktoratës në Statistikë është përgatitja e thelluar në fushën e metodologjisë statistikore, për t'u aplikuar në sfonde të veçanta kërkimore. Fushat e interesit kanë të bëjnë me sektorë të ndryshëm, ato të sipërmarrjes, shoqërisë, ekonomisë, informatikës, biologjisë, mjedisit, etj. Qëllimi i saj është të unifikojë nivelin e përgatitjes së doktorantëve përmes frekuentimit të kurseve të avancuara të statistikës metodologjike dhe të aplikuar si: llogaritje e probabilitetit, inferenca statistikore dhe metodat lineare, metoda statistike për financën dhe fushën e sigurimeve, metoda statistike për administratën publike, teknikat e kampionimit dhe sondazhet demoskopike, marketing strategjik dhe operativ, si dhe metoda statistikore për marketing.

## Dottorato di Ricerca in “Sanità Pubblica, Diagnosi Molecolare delle Malattie Infettive e Farmacovigilanza”

Si è concluso il 17 luglio 2017, il primo ciclo del Dottorato di Ricerca in “Sanità pubblica, diagnosi molecolare delle malattie infettive e farmacovigilanza” dell’Università Cattolica NSBC.
L'obiettivo principale di questo Corso del Terzo Ciclo è quello di preparare esperti nel settore della pubblica sanità e migliorare la loro prestazione professionale. Questo Programma di Studio viene sviluppato come una collaborazione con l’Istituto di Sanità Pubblica “Hulo Hajdëri”, l’Università degli Studi di Bari Aldo Moro ed il Dipartimento di Scienze Farmaceutiche, Università degli Studi di Milano ed è in fase di attivazione per questo anno accademico (2018-2019).

## Doktoratë në "Shëndet Publik, Diagnozë Molekulare të Sëmundjeve Infektive dhe Farmakovigjilancë"

Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” përmbylli në muajin korrik të 2017-ës, ciklin e parë të Doktoratës në “Shëndet publik, diagnozë molekulare e sëmundjeve infektive dhe farmakovigjilancë”.
Qëllimi kryesor i këtij Programi të Ciklit të Tretë është përgatitja e ekspertëve në fushën e shëndetit publik. Në këtë kuadër, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” synon të kontribuojë në përmirësimin e shërbimit dhe të shëndetit publik shqiptar, përmes edukimit specifik profesional. Ky program studimi, që pritet të aktivizohet sërish këtë vit akademik (2018-2019) zhvillohet në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik “Hulo Hajdëri”, Universitetin e Studimeve të Barit, Aldo Moro, si dhe me Departamentin e Shkencave Farmaceutike në Universitetin e Milanos.



# L'Accademia dei "100 villaggi"// Akademia "100 Fshatrat"

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" è parte del progetto l'Accademia dei "100 Villaggi". In questo importante progetto del governo albanese, UCNSBC è rappresentata dalla Facoltà di Scienze Applicate (Architettura). L'obiettivo è quello di utilizzare idee ed esperienze dei docenti, ma anche degli studenti nel settore dell'architettura per la trasformazione di aree rurali o abitazioni. Gli studenti di Architettura rivelano per Pontes i valori e l'importanza di partecipare a questo progetto.

*"**L'Academia dei 100 villaggi** è una fiera delle ricchezze dei villaggi albanesi, dove nascono idee innovative in modo che ogni villaggio che fino adesso era in ombra possa fiorire. Per noi studenti, questa esperienza serve a conoscere meglio il nostro paese, la cultura e il modo di lavorare come professionisti."*

***Megi Ballanca***

*"**L'accademia dei 100 villaggi** è una delle esperienze più belle e fruttuose del mio percorso formativo nel campo dell'architettura fino ad oggi. Durante il lavoro ho avuto la fortuna di toccare da vicino la realtà albanese e anche la professione dell'architetto sul terreno e di capire il forte legame tra architettura con ogni campo della vita e la sua influenza nell'economia".*

***Joana Lamaj***

*"La partecipazione nell'**Accademia dei 100 villaggi** è una esperienza particolare e contemporaneamente anche quella giusta per capire a che cosa andiamo incontro nel campo dell'architettura. Personalmente mi sono sentita alla giusta altezza durante il lavoro di questo progetto. Questo grazie alla preparazione dei professori fiorentini che ci seguono in questa università."*

***Mariglen Gega***

*"La partecipazione in un progetto nazionale come l'**Accademia dei 100 villaggi**, la collaborazione con il Prof. Kamela Guza, Ass. Arch. Dritan Kapo e i futuri colleghi hanno reso questa esperienza di gruppo unica e forte. Lo scambio delle conoscenze e la collaborazione sono la forza di questo progetto."*

***Elisa Miho***

*"La mia esperienza nell'**Accademia dei 100 villaggi** è stata un'avventura. Ho viaggiato con un gruppo gioioso e creativo. Insieme ci siamo incontrati con altre persone, dove ognuno ha portato la sua particolarità. Abbiamo visitato le case tradizionali, castelli, le rovine antiche, e contemplando la diversità dei paesaggi tra spiagge e colline. Quest'esperienza mi ha aiutato a capire ancora meglio il vero potere del mio paese."*

***Joni Zajmi***

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është pjesë e Akademisë "100 Fshatrat". Në këtë projekt të rëndësishëm të Qeverisë Shqiptare, UKZKM kontribuon përmes Fakultetit të Shkencave të Aplikuara (Arkitekturë). Qëllimi është përthithja e ideve dhe eksperiencës së pedagogëve, por edhe të studentëve veçanërisht në fushën e arkitekturës për transformimin e zonave rurale ose shtëpive. Studentët e Arkitekturës UKZKM tregojnë për Pontes se çfarë vlere ka pjesëmarrja në këtë projekt.



*"Akademia 100 Fshatrat është një panair i pasurive të fshatrave shqiptare, nga ku ziejnë ide inovative zhvillimi, në mënyrë që çdo fshat i pashfrytëzuar deri më tani, të lulëzojë. Për ne studentët, kjo eksperiencë vlen për njohjen më thellë të territorit tonë, sikurse dhe përvetësimin e kulturës së të punuarit si profesionistë."*

***Megi Ballanca***

*"Akademia 100 Fshatrat është një ndër eksperiencat më të bukura e frytdhënëse në rrugëtim tim drejt arkitekturës deri më tani. Gjatë punës kam patur fatin jo vetëm të prek nga afër realitetin shqiptar si dhe profesionin e arkitektit në terren, por edhe të kuptoj ndërlidhjen e fortë të arkitekturës me çdo fushë të jetës dhe ndikimin e saj të drejtpërdrejtë në ekonomi."*

***Joana Lamaj***

*"Pjesëmarrja tek **Akademia 100 Fshatrat** është një prej eksperiencave më të veçanta dhe njëkohësisht e duhura për të kuptuar se me çfarë do të na vërë përballë e ardhmja në fushën e arkitekturës. Personalisht ndihem në lartësinë e duhur gjatë punës për këtë projekt. Kjo mbi të gjitha falë përgatitjes nga profesorët fiorentinë, që na ndjekin në universitet."*

***Mariglen Gega***

*"Pjesëmarrja në një projekt kombëtar si **Akademia 100 Fshatrat**, bashkëpunimi me Prof. Kamela Guza, As. Ark. Dritan Kapo dhe me kolegët e ardhshëm kanë bërë që kjo të jetë një ndër eksperiencat më të fuqishme në grup, ku kam marrë pjesë. Shkëmbimi i njohurive dhe bashkëpunimi janë fuqia e këtij projekti!"*

***Elisa Miho***

*"Eksperienca ime tek **Akademia 100 Fshatrat** ka qenë një aventurë. Kam udhëtuar me një grup të hareshëm e kreativ dhe sëbashku u përballëm me një larmishmëri përsonash, secili një personazh i veçantë. Kemi vizituar shtëpi tradicionale, kala, rrënoja antike, si dhe kemi zbuluar diversitetin e peisazheve, mes plazheve e kodrave. Kjo përvojë më ndihmoi të kuptoj akoma më mirë potencialin e vërtetë të vendit tim."*

***Joni Zajmi***

# I Laboratori di Farmacia//
# Laboratorët e Farmacisë

Nel 2007, il campus dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" si è arricchito con due nuovi laboratori contemporanei: il Laboratorio Chimico e il Laboratorio Farmaceutico. Le attività dei laboratori, che servono per la formazione e le esercitazioni degli studenti della Facoltà di Farmacia, vengono coordinate dalla Dott.ssa Arvjola Hodaj.



**Il Laboratorio Farmaceutico:** durante il quarto anno, gli studenti di Farmacia studiano una serie di fasi e principi di progettazione, preparazione e controllo di forme farmaceutiche - solidi, forme semi-solide e preparati galenici. In particolare, gli studenti iniziano a preparare in laboratorio medicine polverose dermatologiche, supposte, pomate, creme, gel, paste, colliri, ecc.

**Il Laboratorio Chimico:** durante il secondo anno di studi, gli studenti si esercitano per la metodologia e l'analisi quantitativa della chimica inorganica. Familiarizzano con le norme di sicurezza e la prevenzione dei rischi di laboratorio, e conoscono le procedure generali di un laboratorio. Durante il quarto anno di studio, le esercitazioni in laboratorio si svolgono sulle metodologie di analisi chimica utilizzate per l'identificazione strutturale e l'analisi qualitativa di molecole farmaceutiche, registrate nella Farmacopea Ufficiale. Questo laboratorio è unico in Albania, per le condizioni didattiche e di sicurezza che offre.

Kampusi i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", që prej vitit 2007 u pasurua me dy laboratorë bashkëkohorë në funksion të praktikës dhe formimit të studentëve të Fakultetit të Farmacisë. Laboratori i Kimisë dhe Laboratori Farmaceutik drejtohen nga Koordinatorja e Laboratorëve, PhD. Arvjola Hodaj.

**Laboratori Kimik**: Gjatë vitit të dytë të studimeve, studentët praktikojnë në laborator, metodikat dhe analizën sasiore të kimisë inorganike. Ata njihen me rregullat e sigurisë dhe parandalimin e rreziqeve të laboratorit, si dhe marrin informacione të përgjithshme mbi proçedurat laboratorike.
Në laboratorin e kimisë, përgjatë vitit të katërt, didaktika zhvillohet mbi metodologjitë e analizës kimike të përdorur për identifikimin strukturor dhe analizimin e cilësisë së molekulave farmaceutike, të regjistruara në Farmakopenë Zyrtare. Laboratori Kimik është një prej laboratoreve unik në Shqipëri përsa i përket kushteve didaktike dhe sigurisë.









**Laboratori Farmaceutik:** Gjatë vitit të katërt, studentët e Farmacisë hyjnë në një seri fazash e parimesh bazë të projektimit, përgatitjes dhe kontrollit të formave kryesore farmaceutike, siç janë format e ngurta, gjysëm të ngurta dhe preparatet galenike. Më konkretisht, studentët fillojnë të përgatisin në laborator ilaçe pluhur të dermatologjisë, suposta, pomada, kremëra, xhel, pasta, kolir, etj.



# L'incubatore delle Idee// Inkubatori i Ideve

L'incubatore delle Idee rappresenta uno dei progetti più importanti dell'Università "Nostra Signora del Buon Consiglio" creato per promuovere idee sostenibili ed innovative.
Nato sotto l'impulso del Magnifico Rettore, Prof. Bruno Giardina, il progetto viene seguito dai Proff. Francesco Rulli (Dipartimento di Scienze Chirurgiche) e Bruno Zappacosta (Dipartimento per la Valutazione Chimico-Tossicologica e Farmacologica dei Farmaci). L'Incubatore si pone come obiettivo principale quello di brevettare e trasformare le idee in business.
Gli incubatori di Start-up, sostenendo le idee più creative ed originali, mettono a disposizione dei giovani ricercatori e/o imprenditori un luogo dove lavorare e trovare un supporto realizzativo professionale; si tratta quindi di un ambiente dove le idee vengono "elaborate" e trasformate in business. Quando le cose funzionano, al momento opportuno scatta il "liberi tutti": con le cosiddette exit gli incubatori monetizzano gli investimenti sostenuti e contano le (eventuali) plusvalenze.

Inkubatori i Ideve është një prej projekteve më të rëndësishëm të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në mbështetje të ideve inovatore dhe të qëndrueshme.
Nën kujdesin e Rektorit të Universitetit Katolik ZKM, Prof. Bruno Giardina, kjo risi po implementohet nga Prof. Francesco Rulli (Departamenti i Shkencave Kirurgjikale) dhe Prof. Bruno Zappacosta (Departamenti për Vlerësimin Kimik-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave). Inkubatori ka për qëllim të patentojë dhe t'i transformojë idetë në biznes.
Inkubatorët START-UP favorizojnë idetë kreative dhe originale, u ofrojnë të rinjve një ambient për hulumtimet e tyre, si dhe mbështetje profesionale. Pra, është vendi i përshtatshëm, ku idetë përpunohen dhe transformohen në biznes. Në bazë të efektshmërisë së projektit të paraqitur dhe në momentin e përshtatshëm, mekanizmi vihet në punë, duke gjeneruar përfitime monetare e njëkohësisht duke mbuluar shpenzimet e investimit.

# Fatti storici// Fakte historike



*Foto senza autore, scattata in Albania // Foto pa autor, e shkrepur në Shqipëri*
*Cortesia dell'Archivio Storico dello Stato Albanese per UCNSBC // Kortezi e Arkivit të Shtetit për UKZKM*

Il XX secolo ha ristabilito gli scambi commerciali tra l'Albania e l'Italia. L'affinità tra i due paesi e le condizioni favorevoli del commercio marittimo, sin dall'epoca della Repubblica Veneziana hanno reso possibile la ripresa di strette relazioni commerciali. Nel '900, l'esportazione italiana in Albania era classificata all'ultimo posto, ma durante il primo decennio tutto cambiò. L'annessione della Bosnia ed Erzegovina fu seguita da un boicottaggio di merci austriache in Albania, lasciando spazio all'esportazione di tessuti italiani.
La fotografia "ROBËQEPËSIA ROMA" (Sartoria Roma), pubblicata da Pontes in anteprima esclusiva, rappresenta al meglio il panorama del '900 in Albania, dove le botteghe tessili, provenienti dall'Italia erano tra le forme di business più diffuse.

Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Italisë rifilluan në shekullin e XX. Afërsia midis dy vendeve dhe kushtet e favorshme të tregtisë detare që prej periudhës venedikase, riaktivizuan shkëmbimet tregtare. Në vitin 1900, eksporti italian drejt Shqipërisë renditej në vend të fundit, por përgjatë dekadës së parë gjithçka ndryshoi. Aneksimi i Bosnje-Hercegovinës u shoqërua papritur me bojkotin e mallrave austriake në Shqipëri, duke i lënë hapësirë eksportit të metrazheve nga Italia.

Fotografia "ROBËQEPËSIA ROMA", e cila botohet për herë të parë, ekskluzivisht nga Pontes, tregon më së miri panoramën rreth viteve 1900 në Shqipëri, ku dyqanet e modës me metrazhe italiane ishin ndër format më të përhapura të biznesit.

La Riunione Adriatica di Sicurtà è stata una compagnia assicurativa italiana, fondata il 9 maggio 1838 a Trieste. Oggi è parte di Allianz, società europea di servizi finanziari. La società è stata attiva durante il '900 in Albania, così come altre attività imprenditoriali italiane. Di seguito, le foto che mostrano le prime forme di marketing, attuate sotto forma di annunci delle imprese di commercio italiano.







"Riunione Adriatica di Sicurtà" ka qenë një shoqëri sigurimesh italiane, e themeluar më 9 maj 1838, në Trieste. Sot është pjesë e Allianz, shoqëri europiane e shërbimeve financiare. Kjo shoqëri sigurimesh e shtriu aktivitetin e vet në Shqipërinë e 1900-ës, ashtu si edhe mjaft biznese të tjera italiane. Më poshtë, paraqiten foto të formave të para të marketingut, përmes reklamave të shoqërive tregtare italiane.

L'industria del trasporto in Albania è fiorita durante gli anni 1935-1944. Tra le varie tipologie di investimenti possiamo accennare le fiere automobilistiche. Tali fiere venivano organizzate da commercianti come i Fratelli Haveriku di Durazzo.





Industria e transportit në Shqipëri mori hov përgjatë viteve 1935-zz1944. Format e investimit në këtë sektor ishin të ndryshme. Vëllezërit Haveriku nga Durrësi, ishin ndër tregtarët e parë që organizuan panaire, ku u ekspozuan modele automjetesh.

La particolarità nell'Albania degli anni '30-'40, la forma più sviluppata di trasporto interno, era il trasporto aereo. Nelle principali città albanesi sono state costruite diverse piste di atterraggio. Le foto appartengono alle strutture interne dell'Aeroporto di Tirana. In questo periodo, i voli erano gestiti dalla compagnia aerea italiana "Ala Littoria".













Në vitet '30-'40, Shqipëria kishte më të zhvilluar transportin e brendshëm ajror krahasuar me format e tjera të transportit. Në qytetet kryesore shqiptare u ndërtuan aerodromë. Fotot i përkasin ambienteve të brendshme të aeroportit të Tiranës, Fusha e Aviacionit. Në këtë periudhë, linjat ajrore menaxhoheshin nga shoqëria italiane "Ala Littoria".



*Aereo civile di linea Tirana – Korça//*
*Aeroplani i linjës Tiranë – Korçë*

Ringraziamo la Direzione Generale Archivi per aver messo a nostra disposizione il materiale.
Falenderojmë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për materialin e vënë në dispozicion.

# La Biblioteca "Fratel Paolo Ruatti"// Biblioteka "Fratel Paolo Ruatti"

La Biblioteca contemporanea dell'Università Cattolica NSBC situata al piano terra dell'edificio, possiede circa 16 mila volumi, tra libri e periodici. La sala di lettura ospita circa 240 posti a sedere e tre postazioni computer a disposizione degli utenti. La ricerca bibliografica può essere effettuata sia sul portale on line (Hinari), che rappresenta il database scientifico, sia attraverso il servizio Document-Delivery. Da poco, è stato reso attivo anche il servizio di Biblioweb, ovvero il catalogo dei libri pubblicato in rete e accessibile da tutti.

A breve, gli studenti dell'UCNSBC potranno avere accesso al database online della biblioteca dell'università partner "Tor Vergata" di Roma.

L'ultima iniziativa della Biblioteca è stata la donazione di un fondo di tremila titoli (copie duplicate). Questo fondo è stato distribuito tra gli studenti universitari, mentre il resto è stato donato agli ospedali partner dove gli studenti della Facoltà di Medicina svolgono il tirocinio e alla sede di Elbasan "Elena Gjika".












Biblioteka bashkëkohore e Universitetit Katolik ZKM ndodhet në katin e parë të godinës qendrore dhe ka një fond prej rreth 16 mijë titujsh, libra dhe revista. Salla e leximit ka një kapacitet prej 240 vendesh studimi dhe është e pajisur me tre kompjuter për konsultimet on-line të periodikëve, si dhe të portalit Hinari, që është databaza kryesore e informacionit shkencor për universitetin, së bashku me shërbimin Document–Delivery. Kësaj pasurie i shtohet edhe Biblioweb, një shërbim katalogimi librash on-line i aksesueshëm edhe nga publiku.
Së shpejti, studentët e UKZKM-së do të mund të përdorin edhe databazën online të periodikëve të Universitetit partner, “Tor Vergata” të Romës.

Dhurimi i një fondi prej tre mijë titujsh (kryesisht kopje të dubluar) është një nismë dhe risi e Bikliotekës. Fondi iu shpërnda fillimisht studentëve të universitetit, ndërsa pjesa tjetër shkoi për spitalet partnere, ku kryejnë praktikën studentët tanë të Fakultetit të Mjekësisë, si edhe në filialin e Elbasanit, "Elena Gjika".




Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rruga Dritan Hoxha, Tiranë

| | |
|---|---|
| web | www.unizkm.al |
| Tel. | +355 4 2273 290 |
| email | info@unizkm.al |
| facebook | unikzkm |
| youtube | unikzkm |
| instagram | unikzkm/pontes_online |
| twitter | unikzkm |